

Raporti individual i konsultimit publik

1. Titulli i projekt aktit: “Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore, lundruese, të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga Policia e Shtetit dhe mjeteve të tjera”

2. Kohëzgjatja e konsultimeve

Specifikoni kohëzgjatjen e përgjithshme të konsultimeve publike sa i përket ditëve të punës, përfshirë datën e hapjes dhe mbylljes së konsultimeve publike; nëse kohëzgjatja ishte më e shkurtër se 20 ditë pune e paraparë me ligj, jepni arsye për shkurtimin e kohëzgjatjes.

Projektligji është hartuar me qëllim rregullimin e procedurave të trajtimit dhe administrimit të mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga Policia e Shtetit dhe mjeteve të tjera.

Hartimi dhe miratimi i këtij projektligji vjen si pasojë e nevojës për gjetjen e një mekanizmi, i cili do të mundësojë zgjidhje efikase për problematikën e krijuar në strukturat vendore të Policisë së Shtetit, ku aktualisht ndodhen 16,445 mjete, me statuse të ndryshme, që kanë krijuar mbartje dhe një problematikë të vazhdueshme, e për të cilat ka pasur zgjidhje për të kryer procedurat e mëtejshme, në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Me anë të këtij projektligji do të zgjidhen disa probleme emergjente, si:

- a. mjetet rrugore, të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit apo ndalimit administrativ nga organet e Policisë së Shtetit, të cilat nuk kanë statusin juridik “provë materiale”;
- b. mjetet lundruese, të regjistruara e të pajisura me lejet përkatëse të qarkullimit/lundrimit nga organet kompetente shqiptare, të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ apo bllokimit nga organet e Policisë së Shtetit;
- c. mjetet rrugore dhe lundruese, të cilat nuk janë të regjistruara e të pajisura me leje qarkullimi nga organet kompetente shqiptare (me ose pa targa regjistrimi/leje qarkullimi/lundrimi nga një shtet i huaj) dhe që janë të konfiskuara si pasojë e sekuestrimit apo ndalimit administrativ nga organet e Policisë së Shtetit;
- d. mjetet e braktisura, të cilat janë identifikuar si objekt i kryerjes së veprës penale, por autori i veprës penale nuk njihet apo nuk është gjetur dhe nuk kanë dokumentacion, mjete që janë ndaluar administrativisht për mangësi në dokumentacion, mjete të braktisura për të cilat nuk është shfaqur interes t’i tërhequr apo mjete të debitorëve.

Në vijim të sa më sipër, projekt-akti u publikua për konsultim publik në platformën RENJKP gjatë periudhës 6 qershor 2024 deri më 3 korrik 2024. Gjatë kësaj periudhe, projekti pati 351 lexime, por nuk u regjistrua asnjë koment nga përdoruesit e platformës.

3. Metodat e konsultimit

Listoni të gjitha metodat e konsultimit të përdorura, të tilla si konsultimet elektronike (Regjistri Elektronik, posta elektronike, faqet e internetit, etj.), Takimet publike, seancat e organeve këshilluese..., dhe siguroni informacione për afatin kohor, kohëzgjatjen dhe afatet e tyre. Shpjegoni se si u shpërnda informacioni mbi konsultimet e hapura, si u ftuan palët e interesuara të kontribuojnë. Përfshini gjithashtu aktivitete nga konsultimet paraprake nëse janë organizuar të tilla).

Për të siguruar një proces gjithëpërfshirës dhe transparent në hartimin e projektligjit “Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore, lundruese, të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga Policia e Shtetit dhe mjeteve të tjera”, janë përdorur katër metoda të ndryshme konsultimi. Më poshtë gjeni një përshkrim të detajuar për secilën nga këto metoda:

1. Përdorimi i Regjistrimit Elektronik për Njoftimet dhe Konsultimet prej datës 6 qershor 2024 deri në 3 korrik 2024, si një mënyrë e cila lejon qytetarët dhe palët e interesuara të paraqesin komente dhe sugjerime në lidhje me projekt aktin përmes internetit, duke siguruar akses të gjerë dhe transparencë në procesin e konsultimit;
2. Takime me grupin e punës në zbatim të urdhrimit të Ministrit të Brendshëm nr. 21 prot., datë 19.1.2024, “Për ngritjen e grupit të punës për vlerësimin paraprak të nismës për propozimin e projektligjit “Për trajtimin dhe administrimin e mjeteve rrugore e lundruese të konfiskuara, si pasojë e sekuestrimit, ndalimit administrativ nga policia e shtetit dhe mjeteve të tjera, deri në datën 31.12.2022”. Këto takime përfshijnë mbledhje të grupit të punës të ngritur posaçërisht për hartimin e projektaktit dhe diskutime të detajuara mbi politikën e propozuar.
3. Komunikime elektronike (nëpërmjet postës zyrtare elektronike), si formë për të komunikuar me individë dhe organizata të interesuara në lidhje me projekt aktin, por gjithashtu edhe për shkëmbime të dokumenteve dhe komenteve midis anëtarëve të grupit të punës dhe titullarëve të institucionit;
4. Takime me përfaqësues të Policisë së Shtetit, Agjencisë së Administrimit të Pasurive të Sekuestruara e të Konfiskuara, Drejtorisë së Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit dhe Prokurorisë së Përgjithshme.

4. Palët e interesit të përfshira

Palët e interesuara të cilët kanë dhënë komente/kontribut në konsultimet publike gjatë procesit të hartimit, janë:

- Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore për Çështjet e Brendshme në MB;
- Drejtoria e Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në MB;
- Drejtoria e Politikave të Rendit dhe Sigurisë Publike;

- Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit;
- Agjencitë dhe institucionet ligj zbatuese;
- Koordinatorin për konsultimin në MB, për mbledhjen e komenteve nëpërmjet RENJKP.

5.Pasqyra e komenteve të pranuar me arsyetimin e komenteve të pranuar/ refuzuara

Gruponi komentet/ propozimet e pranuar sipas çështjes që ato ngritën;

Gruponi komente të ngjashme së bashku dhe renditni palët e interesuara që i ngritën ato;

Shpjegoni cili ishte vendimi i marrë dhe sqaroni shkurtimisht arsyet për të.

Çështja e adresuar (psh. përkufizimi i ri i..., kushtet për regjistrimin e..., rregullimi i..., etj.)	Komenti (grumbulloni dhe përmbliidhni komente identike/të ngjashme nga palët e ndryshme të interesuara së bashku)	Palët e interesuara (renditni të gjithë ata që adresuan çështjen në mënyrë të ngjashme)	Vendimi (I pranuar/I pranuar pjesërisht/I refuzuar)	Justifikimi